



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



Kryetari i Komunës
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
01-Nr- 016-4132
Suharekë me datë: 21.01.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në mbështetje të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, Rregullorës (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, Instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IAAP) të arsimit parauniversitar bënë këtë:

NJOFTIM

Anulohet konkursi 01-Nr-111-59586 i publikuar me datë: 15.09.2025 në SIMBNJ me numër të Referencës: RN00018677 për këtë pozitë:

1. SHFMU "Dituria" - Samadraxhë, Komuna Suharekë,
Pozita: Drejtor shkolle

Pozita e lartëcekuar anulohet sipas vendimit me numër protokoli 01-Nr-016-4125 i datës 21.01.2026, kandidatëve ju është dhënë e drejta për ankesë brenda afatit prej (30) ditëve nga data e njoftimit.

U.D Menaxher i Burimeve Njerëzore
Dul SHALA





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



KRYETARI I KOMUNËS

01-Nr-016-4125

Datë: 21.01.2026

Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 53 lidhur me nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative publikuar në (Gazetën zyrtare nr.20/2016) dhe nenin 44 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **Anulohet** konkursi me nr. protokoli 01-Nr-111-59586 i dates 15.09.2025 për shkak se nuk është formuar komisioni ashtu si e kërkon Rregullorja (QRK) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkpuntorëve profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në institucionet publike edukativo - arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.
- II. **Obligohet** NJMBNJ që ta bën njoftimin publik për anulimin e këtij konkursi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Sipas kërkesës së dërguar nga Drejtoria e Arsimit me nr. protokoli 05.n.36, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka shpallur konkursin për pozitën Drejtor shkolle në SHFMU "Dituria" në Samadraxhë, NJMBNJ ka përfunduar fazën e verifikimit paraprak për kandidatët që kanë aplikuar në konkurs.

Pasi që procedura e pranimi të aplikacioneve të kandidatëve për pozitën e lartëcekur ka qenë e hapur deri më datë 15.10.2025, ku siç dihet Komuna ka qenë në procesin zgjedhor komunal ku si rrjedhojë nuk ka qenë e mundur që të konstituohet kuvendi komunal për formimin e komisionit për pranim në punë si e kërkon Rregullorja (QRK) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkpuntorëve profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në institucionet publike edukativo - arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.

Ashtu si u tha më lartë u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej (30) ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi në Komisionin e Ankesave në Komunën e Suharekës.

KRYETARI I KOMUNËS

Bali MUHARREMAJ

